



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2024

Datë: 20.09.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 8.1 dhe 14 të Rregullores (QRK) numër 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të Arsimit Prauniversitar në mbledhjen e mbajtur me datë 20.09.2024, pas diskutimit lidhur me pikën 8 të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës për institucionet arsimore në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e DKA-së për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Gjakovës.
2. Anëtarët e emëruar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës me propozimin e DKA-së janë :
 1. z. Zymber Berisha, Udhëheqës i Sektorit të Arsimit në Komunën e Gjakovës, kryetar i komisionit.
 2. znj. Zana -Kurtishi -Rudi , Drejtoreshë e Shkollës “Mustafa Bakija” në Gjakovë, anëtare.
3. Anëtari i tretë i këtij Komisioni zgjidhet nga MASH-ti, ashtu siç është paraparë në Rregulloren (QRK) nr.19/2024 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë Komunale për Arsim.
 - Anëtarëve të Komisionit.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit



Arbëneshë Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës